



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit




Raport Statistikor **Shkurt 2018 – Dhjetor 2019**

Komisioni i Pavarur i Kualikimit nga data 8 shkurt 2018 deri në datën 31 dhjetor 2019 ka dhënë **221** vendime.


- **94** vendime për konfirmimin në detyrë të 39 gjyqtarëve, 46 prokurorëve dhe 9 ndihmësve ligjorë/kandidatë për magjistratë;
- **83** vendime për shkarkimin nga detyra të 50 gjyqtarëve, 31 prokurorëve dhe 2 ndihmësve ligjorë/kandidatë për magjistratë;
- **19** vendime për ndërprerjen e procesit të 13 gjyqtarëve, 5 prokurorëve dhe 1 ish-ndihmës ligjor;
- **8** vendime për pushimin e procesit të 3 gjyqtarëve, 1 prokurori dhe 4 ndihmësve ligjorë;
- **16** vendime për përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar, për kryeinspektoren e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, 10 gjyqtarëve dhe 5 prokurorëve;
- **1** vendim për pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare.

Këto vendime pasqyrohen në grafikët e mëposhtëm.

Grafik 1: Vendimet e KPK-së, 8 shkurt 2018 – 31 dhjetor 2019




Grafik 2: Konfirmimet në detyrë në bazë të funksionit të subjektit të rivlerësimit




Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Grafik 3: Shkarkimet nga detyra në bazë të funksionit të subjektit të rivlerësimit




Grafik 4: Ndërprerjet e procesit në bazë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës




Komisioni i Pavarur i Kualifikimit


Grafik 5: Pushimi i procesit sipas nenit 56 të ligjit nr. 84/2016



Grafik 6: Përfundimet e procesit pa një vendim përfundimtar




Grafik 7: Përzullimet nga detyra




Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë **207** vendime me unanimitet, ku të gjithë anëtarët e trupit gjykues kanë votuar në mënyrë të njëjtë dhe **14** vendime me shumicë votash.

Grafik 8: Vendime me unanimitet dhe shumicë votash



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë **25** vendime bazuar në një kriter, **13** vendime bazuar në dy kritere dhe **141** bazuar në të tre kriteret e rivlerësimit.

Grafik 9: Numri i vendimeve sipas kritereve të rivlerësimit



Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pas ankimimit të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, deri më 31 dhjetor 2019, ka marrë 46 vendime nga të cilat:

a) **31** lënie në fuqi të vendimeve të Komisionit;


b) **12** ndryshim vendimi, prej të cilave;

2 vendime të ndryshuara pjesërisht (subjektet M. Fana, A. Llalla) dhe 10 vendime të ndryshuara plotësisht (për subjektet B. Dedja, A. Sevdari dhe A. Faqolli, E. Islamaj, A. Brati, V. Bala, Xh. Zaganjori, G. Osmani, A. Malaj, B. Muçi) ;

c) **1** prishje të vendimit (për subjektin A. Lazaj) ;

d) **2** pushim të shqyrtimit (për subjektin S. Tola dhe subjektin M. Xhaferllari).


Grafik 10: Vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit



Organet ndihmëse të Komisionit në këtë proces janë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) për vlerësimin e pasurisë dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) për vlerësimin e figurës. Vendimmarrja e Komisionit nuk është e kushtëzuar nga përfundimet e rezultateve të këtyre raporteve, pasi Kushtetuta i njej KPK-së të drejtën e një hetimi të pavarur.


Sipas raporteve të ILDKPKI-së për **178** subjekte rivlerësimi, kanë rezultuar pa probleme me pasurinë **119** subjekte rivlerësimi dhe me probleme **59** prej tyre, ndërkohë që hetimi i kryer nga Komisioni ka dhënë rezultate të tjera: kanë rezultuar **80** subjekte pa probleme me pasurinë dhe **98** subjekte me probleme.

Grafik 11: Raporti i ILDKPKI-së dhe rivlerësimi i KPK-së



Nga raportet e DSIK-së për 152 subjekte rivlerësimi, kanë rezultuar të papërshtatshëm për vijimin e detyrës 32 subjekte rivlerësimi, ndërkohë që nga hetimi i Komisionit rezultuan me probleme 21 prej tyre.

Grafik 12: Raporti i DSIK-së dhe kontrolli i figurës i KPK-së



Kualitëkimit